

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Avdiu, kryesues, anëtarët Mediha Jusufi e Ramë Hyseni, (më tej kolegji) në kontestin e paditësit F.K. nga fshati ..., Komuna e Podujevës, i përfaqësuar nga H.P., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN” sh .a. me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga B.S., për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesave të ndërgjyqësve, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, C.nr.582/2010 të datës 20.05.2014, pas mbajtjes të seancës së kolegjit, me datë 06.03.2017 jep:

A K T G J Y K I M

Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, C.nr.582/2010 i datës 20.05.2014, ashtu që gjykohet si vijon:

Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” sh .a. me seli në Prishtinë, që paditësit F.K., në emër të kompensimit të dëmit jo material të pësuar si pasojë e aksidentit në komunikacion (i cili kishte ndodhur me dt. 21.10.2010), për dhembje fizike t’i paguajë shumën prej 1.000 (njëmijë) euro, për frikë shumën prej 900 (nëntëqind) euro, si dhe për shëmtim 1.000 (njëmijë) euro.

Përtej shumës së gjykuar në paragrafin e mësipërm, kërkesëpadia e paditësit kundër të paditurës **refuzohet** në shumën prej 700 (shtatëqind) euro, si dhe kamatëvonesa në këtë shumë.

Paragrafi II. i aktgjykimit ankimor që ka të bëjë me vendimin për dëmin material dhe shpenzimet procedurale, mbetet **i pa ndryshuar**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, me aktgjykimin C.nr.582/2010 të datës 20.05.2014, ka vendosur si vijon:

“I. Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditësit F.K., nga fshati ..., Komuna e Podujevës, si e bazuar.

II. Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” sh.a. me seli në Prishtinë, t’ia paguan paditësit për aksidentin e dt. 21.02.2010 si pasojë e lëndimeve të pësuar dhe atë në emër të kompensimit të dëmit jo material shumën prej 3.600,00 euro, dhe në emër të kompensimit të dëmit material shumën prej 84,29 euro, e të gjitha këto me kamatë vjetore siç e paguajnë Bankat afariste në Republikën e Kosovës, kursimtarëve të vet në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data kur është mbajtur

shqyrtimi kryesor dt. 20.05.2014 e të gjitha në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë:

Në emër të dëmit jo material:

- Në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 1.600,00 euro,
- Për frikë të përjetuar shumë prej 1.200,00 euro,
- Për shëmtim shumë prej 800,00 euro,

Në emër të dëmit material:

- Për shpenzime materiale gjatë kohës së shërimit shumë prej 84.29 euro.

III. përtej shumës së gjykuar për paditësin F.K., si dhe kërkesa për ushqim të sforcuar, për ndihmë dhe përkujdesje të personit të tretë, si dhe kërkesa për rehabilitim klimatik refuzohen si të pabazuara.

IV. Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “NN”, sh.a. me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia kompensoi në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 733.00 euro, të gjitha në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi”.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesit e palëve kanë paraqitur ankesë dhe atë si vijon: Përfaqësuesi i paditësit av. H.P., me dt. 16.06.2014, me të cilën ka kërkuar që aktgjykimi ankimor të ndryshohet, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar, ndërsa ankesa e të paditurës të refuzohet, duke parashtruar këto shkaqe: *Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.*

Përfaqësuesi i të paditurës me dt.20.06.2014, ka paraqitur një ankesë me të cilën ka kërkuar që ta ndryshoj aktgjykimin ankimor, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar ose aktgjykimin ankimor ta prishë dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit: Kolegji, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, e në bazë të shkresave të lëndës vlerësoi se ka juridiksion që në procedurë sipas ankesës të shqyrtoi çështjen dhe të jep vendim. Kompetenca e saj në këtë rast bazohet në nenet 17 e 19 të Ligjit për Gjykatat, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 79/2010”).

Shqyrtimi i lejueshmërisë së ankesës: Kolegji para se të shqyrtoj themelësinë e ankesës paraprakisht në bazë të nenit 196 të LPK, shqyrton se ankesa është e pranueshme në raport me atë se a është paraqitur brenda afatit ligjor, a është e lejueshme dhe a i përmban elementet e parapara me ligj.

Sa i përket afatit për paraqitjen e ankesës: Me nenin 176 të LPK, është përcaktuar se: Kundër aktgjykimit të dhënë në shkallë të parë, palët mund të bëjnë ankim brenda 15 ditësh, nga dita kur palëve u dorëzohet kopja e aktgjykimit përkatës.

Nga shkresat e lëndës (Fletë kthesat mbi dorëzimin e aktgjykimit të shkallës së parë palës ankuese) rezulton se aktgjykimi i shkallës së parë të paditurës tani ankueses i është dorëzuar me dt.06.06.2014. Nga zarfi në shkresa, konstatohet se ankesa është

dorëzuar në postë me dt. 20.06.2014, përmes rekomandesë R.1158750 e që në kuptim të nenit 127 të LPK, konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatën të cilës i është drejtuar ankesa. Përfaqësuesi të paditësit aktgjykimi ankimor i është dorëzuar me dt. 09.06.2014, ndërsa ankesën e ka dorëzuar në gjykatë me dt. 16.06.2014.

Duke llogaritur afatin kohor nga data 09.06.2014 deri me 16.06.2014, konstatohet se ankesa është paraqitur para skadimit të afatit prej 15 ditësh, pra ajo është paraqitur brenda afatit ligjor.

Sa i përket lejueshmërisë: Ankesat janë paraqitur nga përfaqësuesit e palëve procedurale, që kanë interes juridik për paraqitjen e ankesave, nuk ka prova se ankuesit paraprakisht kanë hequr dorë nga e drejta e ankimit, se ankesat e paraqitura janë tërhequr, pra nuk përmbushen prezumimet ligjore të nenit 186.3 të LPK, që ankesa të jetë e palejueshme.

Sa i përket faktit se ankesat a janë të plota: Me vështrim në shkresa të lëndës dhe në kopje të ankesave konstatohet se ato i përmbajnë elementet e përcaktuara me nenin 178 të LPK, dhe mund të procedohet sipas tyre.

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë: Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të LPK, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

Ankesat janë pjesërisht të themelta.

Sa i përket pjesës ndryshuese të aktgjykimit të shkallës së parë:

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore, nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të nenit 182 par.2 nën par. b), g), j), k) dhe m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, dhe nuk ekzistojnë shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 197 i LPK.

Nga gjendja në shkresa rezulton se gjykata e shkallës së parë ka marrë provat e përshkruara në arsyetimin e aktgjykimit ankimor dhe ka konstatuar gjendjen faktike si vijon:

Se në mes të palëve procedurale nuk janë kontestuese faktet se me dt. 21.10.2010, në Podujevë, kishte ndodhur një aksident komunikacioni, si pasojë e të cilit paditësi kishte pësuar lëndime të lehta trupore, frikë, dhembje fizike dhe shëmtim si dhe shpenzime materiale për shërim.

Fakt kontestues mes palëve procedurale ishte se aksidenti a është shkaktuar vetëm me fajin e të siguarit të të paditurës, apo në aksident kishte kontribut edhe paditësi. Për vërtetimin e këtij fakti gjykata e shkallës së parë kishte marr mendimin e ekspertit të komunikacionit për të konstatuar faktet dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur aksidenti. Sipas mendimit të ekspertit të komunikacionit ing. Nexhat Kastrati, rezulton se aksidenti është shkaktuar nga pakujdesia e të siguarit të të paditurës si dhe tejkalimi i shpejtësisë së lejuar gjatë drejtimit të veturës në lokacionin përkatës.

Në bazë të kësaj gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë kishte vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, duke vlerësuar se janë përmbushur kërkesat ligjore nga nenet 185, 200 e 201 të LMD-së, (të vitit 1978). Ndërsa sa i përket shpërblimit të dëmit material vendimin e kishte bazuar në nenin 323.1 të LPK, kurse vendimin mbi shpenzimet në bazë të neneve 449 dhe 452.1 të LPK.

Pretendimet ankimore: Përfaqësuesi i të paditurës në ankesë ka pohuar se aktgjykimi ankimor është përfshirë me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe me arsyetim jo të plotë pasi që nuk është dhënë arsye pse nuk kemi ndarje të përgjegjësisë në këtë rast aksidental, pasi që ekspertët e komunikacionit kanë konstatuar se udhëtari ka pasur mundësi të lëvizë në pjesën e dedikuar për këmbësor, e jo në shiritin e automjeteve. Shumat e gjykuara janë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale si dhe me praktikën gjyqësore, pasi që paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, ndërsa shumat për kompensim janë caktuar sikur të kishte pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme.

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë sipas barrës së provës, drejtë dhe plotësisht ka konstatuar gjendjen faktike, se paditësi si pasojë e aksidentit ditën kritike kishte pësuar lëndime të natyrës së lehtë trupore, si pasojë e të cilave kishte përjetuar dhembje fizike dhe frikë të intensitetit dhe kohëzgjatjes së përcaktuar nga mjekët ekspert, gjithashtu kishte pësuar edhe shëmtim të shkallës së mesme dhe se aksidenti kishte ndodhur nga faji i të siguruarit të të paditurës.

Mirëpo me rastin e vendimmarrjes, kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjykuar shumat si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, për dhembje fizike dhe frikë.

Në këtë rast shumat e gjykuara për format e kompensimit të dëmit nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, e as në praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykatat e Kosovës, për këto forma të shpërblimit të dëmit.

Kolegji, vlerëson se shumat e gjykuara si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 200 të LMD, si dhe në kuadër të kornizave të praktikës gjyqësore të krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Këto shuma përfaqësojnë një satisfaksion adekuat që i dëmtuari (paditësi) t'i përballojë më lehtë dëmet jo pasurore të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para.

Me paragrafin 2 të nenit 200 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" nr. 29/78), si Ligj i zbatueshëm në Kosovë, në bazë të UNMIK Rreg. 1999/24, në momentin e shkaktimit të dëmit, (me tej LMD), është përcaktuar: "*Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror*".

Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve të përjetuara si dhe frikës së të dëmtuarit, ashtu që kompensimi të përfaqësoj një lehtësim në përballimin

e tejkalimit të pasojave të dëmit, që në këtë rast paditësi i ka pësuar në ngjarjen aksidentale, e që përfaqëson edhe qëllimin e dispozitës së lart cituar ligjore.

Sa i përket vendimit të dhënë në aktgjykimin e shkallës së parë që ka të bëjë me kamatëvonesën ai ishte i bazuar në nenin 277 të LMD, sepse LMD i vitit 1978 ishte ligj i zbatueshëm në kohën e shkaktimit të dëmit, në këtë drejtim është krijuar edhe praktika gjyqësore e shprehur në vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës të dhëna me procedurë sipas revizionit (P.sh Aktgjykimi Rev. nr. 359/2014 i dt. 16.12.2014).

Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësuesit të paditësit se aktgjykimi ankimor është dhënë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pretendimet e tilla nuk janë të themelta, ngase duke marr parasysh natyrën e lëndimeve trupore që paditësi ka pësuar nga ngjarja dëmtuese, si dhe intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike dhe frikës, si dhe shkallën e shëmtimit trupor, e duke u bazuar në kriteret vlerësuese dhe praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat në Kosovë, rezulton se gjykata e shkallës së parë kishte gjykuar shuma më të larta për kompensim se sa në raste tjera të ngjashme, andaj në procedurë sipas ankesës, u vendos si në dispozitivin e aktgjykimin të shkallës së dytë.

Sa i përket vendimit për shpenzimet, si dhe për shpenzimet materiale, kjo pjesë e aktgjykimin të shkallës së parë nuk ishte e goditur me ankesë, e që në kuptim të nenit 194 të LPK, nuk ishte objekt i shqyrtimit nga gjykata e shkallës së dytë.

Më sa u tha më lartë e duke u bazuar në nenin 201 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË
CA.nr.2572/2014 dt. 06.03.2017

Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari
Gani Avdiu